



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË FIER

Nr. 805/1 Prot

Fier më, 29/01 /2026

PROCES VERBAL

Mbledhja e Këshillit të Bashkisë datë 29.01.2026. Sot në sallën e mbledhjeve ora 14:30. Të pranishëm në mbledhje 36 këshilltarë.

Znj. Antoneta Çunaj

Përsëritet të nderuar këshilltarë! Fillojmë mbledhjen e këshillit bashkiak, meqënëse është krijuar kuorumi i nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes.

Pika e parë e rendit të ditës.

Miratimi i rendit të ditës me përmbajtjen si më poshtë:

- 1. Miratimi i Rendit të Ditës.**
- 2. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 22.12.2025.**
- 3. Projekt–vendim:** “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin dhjetor 2025.”
- 4. Projekt – vendim:** “Për miratimin e kritereve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok - ndihmën me fondet pushtetit qendror e vendor për vitin 2026
- 5. Projekt–vendim:** “Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier të shtetases Lenë Themi Dimo”
- 6. Projekt–vendim:** “Për miratimin në parim të dhënies me qira të ambienteve të shërbimit pranë Banesave Sociale, zk. 3934, lagjja ‘16 Prilli’, në pronësi të Bashkisë Fier.”
- 7. Projekt – vendim:** “Për shtimin në listën e përfituesve të bursave për nxënësit që ndjekin programet mësimore në arsimin bazë, të mesëm dhe arsimin profesional për vitin mësimor 2025–2026, për të cilin është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 122, datë 22.12.2025, të disa nxënësve.
- 8. Projekt – vendim:** "Për miratimin e masës së subvencionit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe kanë të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar vetë qiranë".”

9. **Projekt – vendim:** “Për mbylljen e përkohshme të godinës së Shkollës 9-vjeçare ‘Petro Baze’, Petovë dhe transferimin e nxënësve në Shkollën 9-vjeçare ‘Halit Grëmi’, Mbrostar.
10. **Projekt – vendim:** “Për miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë ‘ELKOS GROUP’, për vijimin e procedurave administrative për vlerësimin dhe shkëmbimin e pasurive, sipas përcaktimeve të kontratës noteriale nr. 963 rep., nr. 471 kol., datë 20.03.2013, ndërmjet palës porositëse Bashkia Fier dhe palës sipërmarrëse shoqëria ‘Elkos’ sh.p.k.”
11. **Projekt – vendim:** “Për dhënien e pëlqimit për pranimin e donacionit nga subjekti ‘2FAF’ sh.p.k., Fier, me NUIS K12607402Q, në cilësinë e donatorit, për investimin dhe zbatimin e projektit me objekt: ‘Ndërtimi i një kompleksi rekreativ, i përbërë nga dy minifusha dhe një kënd lojërash’, në Njësinë Administrative Portëz, me përfitues Bashkinë Fier.”
12. **Projekt – vendim:** “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘ECO VOLTAGE’ për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore, pasuri në pronësi të kësaj shoqërie.”
13. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e ndryshimit (shtesë fondesh të trashëguara nga Granti i Performancës me burim financimi buxheti i shtetit, si dhe shtesë në buxhet për Grantin e Performancës bazuar në financim të huaj) në VKB nr. 118, datë 11.12.2025, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026’.”
14. **Projekt – vendim:** “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Ervis Ferko, banues në fshatin Qarr, Njësia Administrative Levan, i dëmtuar nga zjarri i datës 03.01.2026.”
15. **Projekt – vendim:** “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Vladimir Kolonjari, banues në lagjen ‘Kastriot’, Njësia Administrative nr. 4, i dëmtuar nga zjarri i datës 17.12.2025.”
16. **Projekt – vendim:** “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për humbjen e vajzës së tyre, shtetasit Algisjon Kazanxhi.”

17. Diskutime dhe komente.

Znj. Antoneta Çunaj

Materialet besoj se ju kanë ardhur të gjithë në mënyrë elektronike. Përsa i takon rendit të ditës ka dikush nga administrata që kërkon fjalën?

Z.Armando Çupa

Përsa i takon rendit të ditës, është pasqyruar edhe elektronikisht në grupin e këshilltarëve që pika 9(nëntë) e rendit të ditës është tërhequr nga ana e administratës për plotësim dokumentacioni.

Znj. Antoneta Çunaj

- Më duket se përveç kësaj pike është edhe një pikë tjetër e cila tërhiqet nga rendi i ditës, prandaj dhe ja dhashë fjalën përfaqësuesit të administratës.

Z.Arbion Behari

Edhe pika 6(gjashtë) e rendit të ditës që ka të bëjë me dhënien e miratimit për dhënien me qira të ambjenteve të shërbimit në Banosat Sociale. E tërheqim në këtë mbledhje për të parë mundësinë nëse këto ambjente mund të përshtaten si banesa sociale dhe të jepen si të tilla dhe jo si ambjente tregtare.

Znj. Antoneta Çunaj

Rendi i ditës që ju paraqitet për miratim është pa pikën 6(gjashtë) dhe pikën 9(nëntë) sikurse u theksua. Kush është dakort ?

Z.Iliria Fili

Më fal kryetare, kam një diskutim të shkurtër përpara se të miratojmë rendin e ditës. Unë do të propozoj dhe kjo më duket e nevojshme, një problem që juve si kryetare e këshillit do t'ju shërbej. Struktura e grupeve politike në këshill ka pësuar ndryshime të mëdha dhe nuk i përgjigjet fare fazës së parë në të cilën ne filluam punë si këshilltarë. Pyetja ime dhe kërkesa ime është: Përbërja e kryesisë dhe stafit drejtues të këshillit i përgjigjet rregullores që ka këshilli dhe ligjit për pushtetin lokal? Prandaj duhet të diskutohet dhe të bëhen ndryshimet përkatëse që kanë ndodhur patjetër në mënyrë që të jemi në përputhje me rregulloren dhe me ligjin.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit inxhinier! Mbarojmë me miratimin e rendit të ditës dhe më pas do të merremi me kërkesën tuaj, ta sqarojmë.

Z.Iliria Fili

Të lutem zonja kryetare. Po flas nga eksperiencia e deritanishme që kam si anëtar këshilli. Sa mbaron shqyrtimi i pikave të rendit të ditës, i tërë grupi që kemi ne këtu, ngrihet dhe largohet nga salla e mbledhjes. Ky nuk është problem i vogël por ka të bëjë me funksionimin normal të këshillit dhe kryesisë së tij. Prandaj unë mendoj të futet dhe të diskutohet në këtë mbledhje këshilli.

Znj. Antoneta Çunaj

I nderuar këshilltar, sa të miratohet rendi i ditës pa filluar shqyrtimi i tyre do të diskutojmë në lidhje me pretendimin tuaj. Tani vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës pa pikën 6-të dhe 9-të të tërhequra nga administrata. Kush është dakort?

Pro 35 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Përveç rendit të ditës me përmbajtjen e mësipërme, kemi edhe 5(pesë) pika shtesë të cilat ju kanë ardhur dhe elektronikisht, konkretisht:

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

3

• **Projekt- vendim:** “Për autorizimin e ekzekutivit të Bashkisë Fier për përfaqësim ligjor dhe mbrojtje juridike pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë edhe nëpërmjet shërbimit juridik të kryer nga një Studio Avokatie , në procesin gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Për miratimin e marrëveshjes së investimit të lidhur nëpërmjet Bashkisë Fier dhe Fondit Shqiptarë të Zhvillimit për projektin infrastrukturor “ Nderhyrje për Rikonstruksionin e Rrugës : Rotondo pranë Kishës Katolike Fier-Hyrje Patos , Bashkia Fier”, dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik” me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore për pajisjen me leje infrastrukture.

Pika e tretë shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Për ngritjen e Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndhimë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier”

Pika e katërt shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Rikonstruksioni i argjinaturës për mbrojtjen nga lumi Vjosa (bankina e krahut të majtë të Degës së Martines, prog. 9958–11308 ml), zona Ferras – Ura e Qarrit, L = 1350 ml”, Bashkia Fier”

Pika e pestë shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Mbrojtja nga përmytja e lumit Vjosa – mbingritja e argjinaturës, zona Kalinores – Klose, vazhdimi i pjesës II (e dytë), L = 1980 m, Bashkia Fier”.


Znj. Antoneta Çunaj

Këto janë 5(pesë) pikat shtesë të rendit të ditës. Përsa i përket argjinaturave janë projekte që nuk presin për shkak edhe të reshjeve të shiut të këtyre ditëve dhe prandaj janë futur edhe në rendin e ditës me emergjencë dhe nuk janë miratuar paraprakisht në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit. Përsa i përket pikës për ngritjen e komisionit, kemi qënë vetë ne si Kryesi Këshilli dhe si Këshill Bashkiak që kemi kërkuar ngritjen e një komision të tillë për të përballuar dhe shqyrtuar fluksin e madh të kërkesave për ndihmë financiare të natyrave të ndryshme nga ana e qytetarëve. Përsa i përket pikës së dytë shtesë, e kemi miratuar në parim në mbledhjet e mëparëshme këtë rikonstruksion tek Kisha katolike në hyrje të rrugës Fier-Patos. Tani përmes projekt-vendimit të ardhur do të kryhet procedura administrative e shpronësimit për këtë rikonstruksion që edhe kjo rrugë të bëhet me standarde bashkëkohore. Përsa i përket pikës së parë shtesë, kemi të bëjmë me kërkesën e ekzekutivit për të marrë një studio të specializuar avokatie, që së bashku me ekzekutivin do të bëjnë mbrojtjen në Gjykatën Administrative, për shkak të natyrës së veçantë të çështjes.

Znj.Alda Kapllanaj

Më fal, kryetare ta sqaroj pak këtë pikë shtesë të rendit të ditës. Kemi të bëjmë me një legjislacion i cili nuk ka të bëjë me Këshillin Bashkiak dhe Bashiknë por është një legjislacion tatimor , ka të bëjë me procedurat tatimore. Ne si administratë njohim dhe zbatojmë legjislacionin që ka të bëjë me taksat dhe tarifatat vendore si dhe atë të vetëqeverisjes vendore. Kurse legjislacioni tatimor dhe atë të procedurave

4



tatimore nuk e njohim në thellësi, dhe për këtë kemi kërkuar edhe asistencën e një studioje avokatie të specializuar në këtë fushë.

Znj. Antoneta Çunaj

Kush është dakort edhe me shtimin për shqyrtim të këtyre 5(pesë) pikave shtesë të rendit të ditës?

Pro 35 vota.

Kundra 1 votë.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Kreshnik Dapi

Kryetare, me leje? Po ju vë në dijeni për një anomali, që edhe bashkë kemi qënë në diskutim që nga dita e hënë. Ne po fillojmë mbledhjen sot, po këshillin e ke pa paga, pa shpërblim. Nuk e ngre këtë shqetësim sepse mungojnë ca lekë në llogaritë tona personale, se për hirë të së vërtetës për shumë nga ne është një vlerë modeste, dhe për disa të tjerë mund të jetë e konsiderueshme, por tregon një problematikë që ne na ka shoqëruar këto kohë sidomos dhe me procese të tjera, konkretisht te Komisioni i Strehimit, kemi patur problematikë. Sipas specialistëve për tu loguar në sistem dhe shumë aplikime, siç do ta dëgjoni dhe më mbrapa kur të vijë pika në fjalë, janë kërkuar nga qytetarët të bëhen në mënyrë të drejtpërdrejtë ose dorazi te zyra me një ndalesë. Tani, mqs kryetari i bashkisë nuk është, nuk e di se kush mund të na ofrojë një shpjegim shterues sepse ne, për kolegët që nuk e dinë kemi që nga e hëna me këtë problem. Na është thënë që janë çuaj dorazi. Edhe njëherë, neve nuk na shqetëson fare që nuk kanë ardhur ato fonde në llogaritë tona, dyshimi është që çfarë po ndodh realisht dhe ku është problemi në funksionimin normal të disa hallkave të ekzekutivit.

Znj. Antoneta Çunaj

Më fal një minutë që të të sqarojë unë paraprakisht . Siç të kam informuar dhe më parë përmes telefonit. Kam kontaktuar me zyrën e financës së bashkisë. Nga ana ime është firmosur në kohë listprezenca e pagesës suaj por nuk ka funksionuar portali a-albania, ka patur një difekt dhe para dy ditësh është konfirmuar që mqs po zgjat në kohë mosfunksionimi i portalit, sepse të gjitha procedurat kryhen përmes këtij portali, i është dhënë detyrë administratës, më konkretisht financës që këtë ta bëjë dorazi dhe me sa di unë financa e ka çuar të gjithë urdhërpagesat e këshilltarëve i ka çuar dorazi, dhe tani pritet banaka që të bëjë veprimet, pasi dhe banka ka ato procedurat e veta për ti hedhur në sistem. Por realisht nga ana e bashkisë ka përfunduar puna për marrjen e pagës sonë. Kjo është , në bankën Raiffaisen.

Z.Kreshnik Dapi

Kryetare të lutem. Shqetësimi nuk ishte për pagat, sepse për atë jam në dijeni. Problemi i dytë është aksesit i shërbimit e-albania.

Znj.Pranvera Cina

Siç jeni dhe në dijeni, aksesit në shërbimin e-albania ka patur problematikë gjatë kësaj periudhe.

Znj.Evis Sema

Kryetare më fal për ndërhyrjen, mbase nuk është ndërhyrja e duhur, por nuk është problematikë e bashkisë për mosfunksionimin e portalit e-albania. Të merremi me gjërat e tjera .

Z.Kreshnik Dapi

Nuk e kuptoj ndërhyrjen e zonjës Sema. Znj. Sema të jetë pak më e qetë para se të flasi. Mua më vjen keq për fatkeqësinë që asaj i ka ndodhur, por ajo duhet ta dijë që kur flas unë, flas si anëtar i kryesisë dhe si sekretar i saj. Dhe si nënkryetar i atij Komisionit të Strehimit që ka përgjegjësi ligjore së bashku me kolegët e tjerë. Të lutem znj.Sema mos bëj zhurmuesen këtu dhe shiko punën tënde.

Znj. Antoneta Çunaj

Mqs në bazë të rregullores së këshillit dhe kërkesës që bëri një anëtarë i këshillit në lidhje me përkatësinë e secilit anëtarë të këshillit bashkiak në grupet politike, dhe si pasojë edhe në Kryesinë e Këshillit Bashkiak, si dhe si pasojë e lëvizjeve që kanë ndodhur në Partinë Demokratike, e cila në momentin që është konstituuar ky këshill drejtohej nga Z.Basha, dhe më vonë pas vendimit të Gjykatës së Apelit, drejtimi i kësaj partie iu njoh Z.Berisha, i kërkoj të gjithë anëtarëve të këshillit të dorëzojnë pranë sekretariatit të këshillit një deklaratë, ku të deklarojnë përkatësinë e tyre politike.

Z.Endri Jaupaj

Sa për dijeni edhe të profesorit i cili bëri dhe kërkesën, anëtarët e këshillit mund të jenë dhe të pavarur.

Znj. Antoneta Çunaj

Me sqarimin që sapo unë bëra e quaj të ezauruar këtë problem.

Z.Kreshnik Dapi

Kemi një kërkesë të bërë nga Znj.Morina në lidhje me këtë problem. Nuk do ta shqyrtoni tani?

Znj. Antoneta Çunaj

Jo, kërkesat dhe diskutimet jashtë rendit të ditës do të shqyrtohen në fund.

Pika e dytë e rendit të ditës.

Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes së Këshillit, datë 22.12.2025.

Znj. Antoneta Çunaj

Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 22.12.2025. Materiali u është dorëzuar të gjitha forcave politike, është firmosur prej tyre. Kush është dakort ?

Pro 36 vota.

Kundra s`ka.

Abstenim s`ka .

Miratohet.

Pika e tretë e rendit të ditës

Projekt–vendim: “Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar 6 %, për muajin dhjetor 2025.”

Znj. Antoneta Çunaj

Kjo është një procedurë që ndiqet çdo muaj, lista vjen në mënyrë elektronike. Materiali ju ka ardhur elektronikisht. Ka ndonjë diskutim? Jo. E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e katërt e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e kriterëve për familjet në nevojë që do të trajtohen me ndihmë ekonomike deri në 6% të fondit të kushtëzuar për bllok - ndihmën me fondet pushtetit qendror e vendor për vitin 2026

Znj. Antoneta Çunaj

Të flasi në fillim përfaqësuesja e administratës, shkurt, sepse materiali ju ka ardhur elektronikisht.

Znj.Mirela Pitushi

E nderuar kryetare, të nderuar këshilltarë! Siç është bërë tashmë praktik edhe nga vitet e kaluara, në fillim të vitit në bazë të VKM 597 të vitit 2012 dhe në bazë të Ligjit bazë të Shërbimit Social me nr.57 të vitit 2019, kalojnë për miratim kriteret në Këshillin Bashkiak brenda kuadrit ligjor, për përfitimin e ndihmës ekonomike për familjet dhe personat që nuk shpallen fitues nga sistemi, për ata që ju referohen atij motivacioni, mospërfitim ndihme. Këto kriterë kanë kaluar në Komisionin e Mirëqënies Sociale, dhe për t'ua bërë me dije juve po jua ritheksoj. Bëhet fjalë për persona në kushte sociale ekonomike të vështira, pa të ardhura ose me të ardhura të pa mjaftueshme, gra kryefamiljare të vetme dhe të divorcuara, në moshë të madhe të veja, me fëmijë të mitur jetim, kryefamiljarë me persona me aftësi të kufizuar që nuk përfitojnë pagesën e paaftësisë etje. Siç dhe e dini këto kriterë kanë qënë prej tre vitesh në Këshillin Bashkiak dhe shpresoj që të miratohen edhe këtë vit nga ana juaj. Për çdo paqartësi kemi edhe specialistët e fushës që mund të referojnë.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë paqartësi në lidhje me pikën katër të rendit të ditës? Nuk ka . E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e pestë e rendit të ditës.

Projekt–vendim: “Për pranim në Shtëpinë e të Moshuarve Fier të shtetases Lenë Themë Dimeo”

Znj. Antoneta Çunaj

Materiali ju ka ardhur elektronikisht. Bëhet fjalë për një të moshuar. Nuk besoj që ka diskutime për këtë pikë, apo jo? Nuk ka. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e gjashtë e rendit të ditës.

Projekt–vendim: “Për miratimin në parim të dhënies me qira të ambienteve të shërbimit pranë Banesave Sociale, zk. 3934, lagjja ‘16 Prilli’, në pronësi të Bashkisë Fier.”

Znj. Antoneta Çunaj

Kjo pikë sikurse u tha dhe në fillim të mbledhjes u tërhoq nga ana e Ekzekutivit. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës.

Pika e shtatë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për shtimin në listën e përfituesve të bursave për nxënës të ndjekin programet mësimore në arsimin bazë, të mesëm dhe arsimin profesional për vitin mësimor 2025–2026, për të cilin është miratuar Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 122, datë 22.12.2025, të disa nxënësve.

Znj. Antoneta Çunaj

Ky material ju ka ardhur elektronikisht. Nëse ka ndonjë paqartësi. Kush e do fjalën nga anëtarët e këshillit? Po inxhinier.

Z.Ilia Fili

Ne kemi miratuar më shpejt në parim, dhe më pas kemi miratuar dhe një listë të nxënësve që përfitojnë bursa. Unë do ta konsideroja një shumë modeste për këto familje që kanë këta fëmijë, por më habit një gjë, çdo muaj ne po na vijnë dy deri në tre nxënës të rinj që kërkojnë bursa për shkollë. Për këtë arsye unë pyes: Drejtoritë e shkollave e kanë listën e nxënësve komplet? Dhe nuk i dinë këta nxënës?

Znj. Antoneta Çunaj

Ta sqaroj pak, inxhinier. Vijnë kërkesat me vones. Ta sqarojë përfaqësuesi i administratës

Z.Ilia Fili

Më fal që ta them deri në fund mendimin. Që në shtator që fillon viti i ri shkollos, drejtoritë e shkollave kanë listën e plotë të nxënësve dhe kur përpiluan listën që na e sollën ne këtu dhe që e miratuam njëherë duhet të mendonin për të gjithë kategoritë e nxënësve që përfshihen. Ndërsa ne po shohim që në çdo mbledhje po vijnë nga dy deri në tre nxënës të rinj. Pse ky mos seriozitet në vlerësimin e të gjithë kategorive të nxënësve?

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Unë do të jap një sqarim thjesht përse më takon nga ana ligjore, pavarësisht se nuk jam anëtare e Komisionit të Bursave. Patjetër që brenda muajit dhjetor, është afati i fundit kur miratohen listat e përfituesve të bursave nga bashkitë. Gjithë procesi duhet të koordinohet me drejtorët e shkollave respektive si profesionale dhe të arsimit të përgjithshëm. Kjo gjë ka çaluar, për mendimin tim. Gjithësesi ne i shoshitëm gjërat dhe arritëm të miratojmë në fund listën përfundimtare të të gjithë nxënësve përfitues të bursave. Këto që ju paraqiten janë vetëm dy nxënës të cilët nuk janë sjellë, janë përcjellë në

datën 18.12.2025 pranë nesh dhe në atë ditë në mbledhjen e Kryesisë së Këshillit kishin kaluar pikat e rendit të ditës për miratimin e bursave. Dhe në momentin që ne nuk i kemi plotësuar dhe nuk janë parë dokumentacionet, nuk janë sjellë nga komisioni. Bëhet fjalë vetëm për dy nxënës të cilët nuk kapën afatin për tu paraqitur në atë atë mbledhje në këshillit. Është edhe një nxënës i cili është anëtarë i katërt i një familje ku tre anëtarët e tjerë, nxënës, e kanë përfituar dhe gabimisht nuk është hedhur në tabelë.

Z.Kreshnik Dapi

Me leje kryetare. Kemi dhe një fëmijë i cili me sa duket mbase dhe nga kjo problematika e logimit në sistem të e-albania, nuk kishte arritur dot dhe i ka prurë dokumentat dorazi, sepse kështu u shpreh e ëma, fizikisht edhe në sekretarinë e këshillit, në adresën tonë të Kryesisë së Këshillit me lutje për ta përfshirë në këtë shtesën që do të bëjmë sot me këto dy emrat e tjerë.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Në rregull. Do të verifikohet dokumentacioni i sjellë për këtë fëmijë dhe nëse dokumentacioni është në rregull pse jo.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka diskutime të tjera? Nuk ka. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e tetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: "Për miratimin e masës së subvencionit të qirasë për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe kanë të ardhura të pamjaftueshme për ta përballuar vetë qiranë".

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht, është mbledhur komisioni për këtë pikë të rendit të ditës?

Znj.Mirela Pitushi

E nderuar kryetare! Në bazë të ligjit 22/2018, u ngrit komisioni për shqyrtimin dhe nga stafi mbështetës u bë paraqitja e kërkesave dhe dokumentacionit nga personat e interesuar. U krye shqyrtimi i kërkesave dhe dokumentacionit nga struktura, u bë verifikimi i përputhshmërisë së adresës së banimit sipas kontratës së qirasë dhe në bazë të disa kritereve që dolën nga grupi, ku familjet me prioritet dolën familjet në ndihmë ekonomike, gratë kryefamiljare pa të ardhura, viktimat e dhunës dhe ato me urdhër mbrojtje, të moshuar pa banesë, familjet invalide etje. Kemi aktualisht 24(njëzet e katër) familje përfituese. Janë të gjitha brenda kritereve dhe për sqarim, 80% të kësaj shume është akorduar nga ministria dhe 20% akordohet nga bashkia. Faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

Sqarime të tjera ka dikush tjetër për të bërë?

Z.Endri Jaupaj



Unë do të doja që mqs jemi dhe në transmetim live, ti bëja thirrje të gjithë familjeve të interesuara të aplikonin sepse nuk më del llogaria që në një qytet të tillë si Fieri ku kemi rreth 200 mijë banorë të deklaruar, të kemi kaq pak kërkesa sepse nuk më përputhen këto shifra. Ne kalojmë vetëm 24(njëzet e katër) familje sepse jam edhe vetë pjesë e Komisionit të Strehimit, jam anëtarë i këtij komisioni. Duhet të kemi më shumë familje, duhet të punojë administrata dhe zyra përkatëse, aq më tepër që 80% e kësaj shume e mbulon qeveria dhe duhet të shkojmë të paktën tek shifra e 100 familjeve. Besoj që i përkon pjesës së 200 mijë banorëve. Nuk besoj që jemi një qytet kaq i pasur që nuk kemi kërkesa për bonus qiraje. Këtë kisha. Meraku im është që burokracitë nëpër institucione të jenë sa më të pakëta në mënyrë që ta lehtësojnë këtë proces.

Znj. Antoneta Çunaj

Çfarë ka ardhur në këshill është miratuar, se çfarë do të ndodhi në të ardhmen këtë nuk e dimë. As administrata dhe as këshilli nuk janë bërë pengesë për këtë proces. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e nëntë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për mbylljen e përkohshme të godinës së Shkollës 9-vjeçare ‘Petro Baze’, Petovë dhe transferimin e nxënësve në Shkollën 9-vjeçare ‘Halit Grëmi’, Mbrostar.

Znj. Antoneta Çunaj

Kjo pikë sikurse u tha dhe në fillim të mbledhjes u tërhoq nga ana e Ekzekutivit. Kalojmë tek pika tjetër e rendit të ditës.

Pika e dhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin në parim të kërkesës së shoqërisë ‘ELKOS GROUP’, për vijimin e procedurave administrative për vlerësimin dhe shkëmbimin e pasurive, sipas përcaktimeve të kontratës noteriale nr. 963 rep., nr. 471 kol., datë 20.03.2013, ndërmjet palës porositëse Bashkia Fier dhe palës sipërmarrëse shoqëria ‘Elkos’ sh.p.k.”

Znj. Antoneta Çunaj

Dua t’ju sqaroj paraprakisht që është bërë një akt-marrëveshje në kohën kur ka qënë kryetar i bashkisë Z.Baftjar Zeqaj dhe ka rënë dakort që kjo shoqëri ‘ELKOS GROUP’ të ndërtojë pallatin e sportit pranë ETC-së, dhe realisht ai është ndërtuar por ende nuk ka vazhduar procedura e këmbimit për të verifikuar se sa % të kësaj kontrate është bërë nga ana e ‘ELKOS GROUP’. Duhet të bëhet kontrata e shkëmbimit që kjo pronë e ndërtuar të merret nga ana e bashkisë dhe të kalojë në emër të Bashkisë Fier. Sepse ka kryer një investim për llogari të bashkisë duke i dhënë ne si shkëmbim, një sipërfaqe tokë në kohën që ka qënë kryetar i bashkisë Z.Baftjar Zeqaj, dhe ne duam që ky investim që ka përfunduar dhe që realisht administrohet nga bashkia dhe investohet për mirëmbajtjen e tij nga bashkia, aktualisht të kalojë dhe me dokumenta ligjore në pronësi të Bashkisë Fier. Kjo është. Tani nëse do ndonjëri ndonjë sqarim? Po inxhinier.

Z. Ilia Fili

Mos flitet edhe për detyrimet që ka bashkia ndaj shoqërisë ?

Znj. Antoneta Çunaj

Nuk ka detyrime bashkia ndaj kësaj shoqërie. Detyrim kanë ata ndaj nesh. Të flasi përfaqësuesi i bashkisë.

Z. Arbion Behari

Bashkia Fier bazuar në një vendim të Këshillit Bashkiak, ka lidhur një kontratë sipërmarrjeje me shoqërinë “ ELKOS”, shoqëri e cila do të investonte për ndërtimin e kompleksit sportiv pranë ETC-së dhe do të përfitonte si shkëmbim një sipërfaqe toke të cilën do ta përdorte si parkim. Vlera e investimit do të ishte sipërfaqja e truallit që do të përfitonte x çmimin e referencës së sipërfaqes truall në atë zonë, që përkthehet në një vlerë afërsisht 78 milion lekë të reja dhe kjo ishte vlera e investimit që do të investonte shoqëria. Pasi shoqëria e ka kryer investimin dhe në bazë të situacioneve që disponon, i është drejtuar bashkisë për vazhdimin e procedurave të mëtejshëm për vlerësimin e investimit dhe vijimin e procedurave të shkëmbimit të ambjenteve. Ja kemi paraqitur Këshillit Bashkiak për miratimin në parim të kësaj kërkesë në mënyrë që pas verifikimit të vijohet me ngritjen e një grupi të punës për vlerësimin e të gjithë investimit të kryer atje dhe vijimin e procedurave të mëtejshme administrative të shkëmbimit të ambjenteve.

Znj. Antoneta Çunaj

U sqaruat? E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim 2 vota .

Miratohet.

Pika e njëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për dhënien e pëlqimit për pranimin e donacionit nga subjekti ‘2FAF’ sh.p.k., Fier, me NUIS K12607402Q, në cilësinë e donatorit, për investimin dhe zbatimin e projektit me objekt: ‘Ndërtimi i një kompleksi rekreativ, i përbërë nga dy minifusha dhe një kënd lojërash’, në Njësinë Administrative Portëz, me përfitues Bashkinë Fier.”

Znj. Antoneta Çunaj

Në lidhje me këtë projekt-vendim, dua t'ju sqaroj që bëhet fjalë për një donator të nderura, një tregtar që dëshiron që në këtë njësi administrative të Bashkisë Fier, të bëjë një investim në lidhje me dy fusha sportive dhe kënd lojërash të cilën pas investimit ja jep dhuratë Bashkisë Fier dhe konkretisht Njësisë Administrative Portëz.

Z. Endri Jaupaj

U shtofshin të tillë biznesmen se mundësi të tjera s'ka.

Z. Ilia Fili

Kam frikë se pas një ose dy muajsh do të na sillni këtu në këshill ndonjë material që kjo kompani, kjo firmë, ky donator, do të kërkojë diçka në shkëmbim të investimit që ka bërë.

Znj. Antoneta Çunaj

Inxhinier, ne këtu jemi. Sot për sot ai nuk kërkon asgjë. A ka ndonjë tjetër që do të flasi në lidhje me këtë pikë? Nuk ka. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Z.Kreshnik Dapi

Kryetare, me leje? Mqs jemi në këtë pikë dua të bëj një falenderim dhe si përfaqësues i shumë banorëve tek ajo njësi, për Z.Mariglen Hoxha, i cili është kryetar i këtij projekti, e ka kryesuar, bërë të mundur gjithë procedurën, insitoi deri në fund dhe bashkarisht do të jemi kur ta inagurojmë atje. Faleminderit!

Z.Mariglen Hoxha

Na u shtofshin sa më shumë.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit, dhe na u shtofshin dhe qëntë ogur i mbarë për të sjellë dhe të tjera investime.

Z.Endri Jaupaj

Sepse ne investime s'kemi sepse ishim të fundit, sepse nuk e lexove ti kryetare.

Pika e dymbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Mbi miratimin e kërkesës së shoqërisë ‘ECO VOLTAGE’ për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore, pasuri në pronësi të kësaj shoqërie.”

Znj. Antoneta Çunaj

Pra është pasuri private. Komisioni është mbledhur në lidhje me këtë pikë të rendit të ditës?

Znj.Erlida Llupi

Përsëritje! Komisioni i Ekonomisë e zhvilloi mbledhjen në datën 27.01.2026 dhe e dërgoi këtë pikë në këshill për miratim me tre vota pro dhe dy vota kundër.

Znj. Antoneta Çunaj

Po, faleminderit! Bëhet fjalë për një subjekt që ka një pronë private. Ne si këshill nuk marrim vendime në lidhje me ndryshimin e bonitetit të tokës, toka është pronë e tij nuk është pronë e bashkisë, ne vetëm hapim krahun për kërkesën, që kërkesa e tij të shkojë në institucionet përkatëse dhe janë ato që marrin vendimin nëse për këtë tokë do të ketë vendimmarrje për bonitet apo jo.

Z.Endri Jaupaj

Përpara se të vijë tek ne, Ekzekutivi kontrollon dokumentacionin, e ka dokumentacionin për bonitetin përpara, dhe formularin 6-të gjithashtu dhe pastaj e sjell këtu.

Z.Kreshnik Dapi

Për procedurë. Është mbledhur komisioni. Kemi dokumentat përpara nga bashkia, flasim ne pastaj flasin titullarët e bashkisë. Si anëtarë i Komisionit të Ekonomisë, unë kam votuar kundër bashkë me Z.Arben Çuko. Pse? Dua ta sqaroj më poshtë të konkretizuar arsyen e votimit kundër. Në vijim të shqyrtimit të relacionit të hartuar nga grupi i punës (ngritur me urdhrin Nr. 29, datë 05.01.2026), lidhur me kërkesën e shoqërisë "ECO VOLTAGE" për ndryshimin e kategorisë së tokës bujqësore (Bonitetit) për pasuritë në ZK 3038, fshati Povelçë, paraqesim këtë material për refuzimin e kërkesës bazuar në arsyet e mëposhtme:

1. Mosplotësimi i kriterëve ligjore të parashikuara në VKM Nr. 121, datë 17.02.2011 Sipas Kreut V, pika 2, gërma (a) e kësaj VKM-je, dokumentimi i forcës madhore duhet të jetë i konfirmuar dhe nënshkruar detyrimisht nga inspektori i IMT-së në Këshillin e Qarkut Fier. Relacioni konstaton qartë se në procesverbalet e vitit 2015 mungon nënshkrimi i këtij specialisti. Ky është një element i formës ligjore që e bën dokumentacionin të pavlefshëm për të provuar ndikimin e faktorëve natyrorë.

2. Papajtueshmëria e objektit të dëmtimit me kërkesat e ligjit. Veprimi i forcave madhore kërkohet të vërtetojë dëmtime fizike të vetë tokës. Procesverbalet e datës 05.04.2015, të paraqitura nga shoqëria, i referohen ekskluzivisht dëmtimit të kulturave bujqësore dhe jo ndryshimit të strukturës fizike të truallit. Dëmtimi i prodhimit bujqësor sezonal nuk përbën bazë ligjore për ndryshimin e përhershëm të kategorisë së bonitetit të tokës.

3. Mungesa e vlerësimit teknik bashkëkohor nga organi kompetent (QTTB). Vërtetimet e bonitetit të paraqitura nga kërkuuesi i referohen vlerësimeve të viteve 1985-1988. Megjithatë relacioni citon një kohë të gjatë prej rreth 40 vjetësh, nuk është paraqitur asnjë analizë e re laboratorike apo matje nga Instituti i Tokës (QTTB). Pa një akt-ekspertimi shkencor të azhurnuar, pretendimet për degradim të strukturës së tokës mbeten të paprovuara teknikisht.

Znj.Evis Sema

Kryetare, nuk i përkasin Këshillit këto.

Znj.Erald Qirjo

Kryetare mund ta shpjegojë pak?

Znj. Antoneta Çunaj

Ju lutem mësoni të mbarojë këshilltari .

Znj.Evis Sema

Po flas në cilësinë e kryetares së Këshillit të Qarkut i cili ka dhe nën varësi dhe Drejtorinë e Administrimit të Pronës

Znj. Antoneta Çunaj

Mësoni të flasë këshilltari sepse është dhe anëtarë i komisionit përkatës dhe po argumenton votën kundër.

Z.Kreshnik Dapi

13



Mos bëj zhurmuesen, kryetare përjashtoheni nga salla këtë se na çmëndi. Je në mbledhjen e këshillit këtu, nuk je tek ajo shkolla private që jep mësim fshehurazi. Për shkak të asaj fatkeqësisë që të ka ndodhur, nuk doja të merresha me ty sot, dhe duhet të japësh shpjegim këtu për këtë që sapo thashë.

Znj.Evis Sema

Kryetare, kërkoj që pas fjalës së Z.Dapi të më japësh fjalën për të dhënë shpjegimet përkatëse për këtë që sapo tha Z.Dapi.

Znj. Antoneta Çunaj

Po, patjetër dhe lëreni të flasi deri në fund, mos flisni mbi njëri tjetrin sepse do të flasi përfaqësuesi i bashkisë për të dhënë sqarimet përkatëse.

Z.Kreshnik Dapi

4. Mosvërtetimi i dëmtimit të pakthyeshem. Ligji lejon ndryshimin e kategorisë vetëm kur mbi sipërfaqe kanë vepruar faktorë si tërmete, vullkane apo fundosje të shtresave të tokës. Prezenca disaditore e ujit në vitin 2015 nuk provohet të ketë shkaktuar një tjetërsim të tillë fizik që të diktojë uljen e kategorisë së tokës nga shkalla VIII në një kategori tjetër pa një rivlerësim teknik paraprak.

Si perfundim:Për arsyet e mësipërme, kërkesa e shoqërisë “ECO VOLTAGE” vlerësohet si e parakohshme dhe ligjërish e paplotë. Propozohet refuzimi i saj deri në plotësimin e dosjes me: Konfirmimin zyrtar nga IMT e Këshillit të Qarkut; Akt-vlerësimin teknik të azhornuar nga Instituti i Tokës (QTTB) mbi gjendjen fizike të truallit

I takojnë më së miri Komisionit të Ekonomisë dhe Këshillit. Ne nuk kemi gjë me biznesin. Ai le ta gëzojë dhe ta zhvillojë atë pronë por të dijë kufijtë dhe hallkat që i lejon ligji.

Znj. Antoneta Çunaj

Të flasi tani përfaqësuesi i bashkisë pastaj fjalën e ka Znj.Sema.

Znj.Erald Qirjo

Përsëndetje kryetare, përsëndetje të gjithëve! Ashtu sikurse edhe Z.Dapi e lexoi shumë mirë pjesën e VKM-së , dhe vet e përmendi, kur ka ndikim nga faktorët natyror atëherë përbën objekt për ndryshimin e kategorisë së tokës. Këtë të drejtë e ka çdo lloj subjekti, çdo fermer, çdo person që ka një pronë dhe kërkon të ndryshojë kategorinë e tokës. Që të ndryshojë kategorinë e tokës duhet ti drejtohet Këshillit Bashkiak për të hapur rrugën. Nuk e ndryshon Këshilli Bashkiak kategorinë e tokës, janë institucione të tjera nëpër të cilat kalon kjo procedurë si Këshilli i Qarkut, Ministria dhe nëpërmjet Qendrës së Studimit të Tokave Bujqësore. Ashtu siç u përmend dhe në relacion, të gjitha dokumentat, certifikata e pronësisë dhe vërtetimet e Këshillit të Qarkut dhe kontratat që ka lidhur me fermerët për tokat që kanë kaluar në emër të kompanisë janë , dhe unë jua kam vënë në dispozicion dhe ju nuk i keni marrë vet. Kështu që kjo përben rrugën për të vazhduar procedurën e mëtejshme të kësaj kompanie. I rash shkurtimisht sepse po të zgjatëm duhet të lexojë një relacion prej katër faqesh dhe kështu do ti haja kohë të çmuar këshillit. Por thelbi është ky: Sikurse e përmendi dhe vet Z.Dapi, faktorët natyrorë kanë ndodhur, janë të provuara. Pavarësisht se procesverbali përkatës që duhet të mbahej për dëmtimin e strukturës së tokës, nuk është mbajtur, por është mbajtur ai i dëmtimit të kulturës bujqësore, gjë që provon që atje ka ndodhur faktorë natyror dhe që përbëjnë faktor madhor. Faleminderit.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit, fjalën e ka Znj.Sema.

Znj.Evis Sema

Kryetare të lutem, në respekt të të gjithëve, do të doja që të mos më ndërpriste asnjë njëri në fjalën time, dhe mqs ma përmendi këshilltari Z.Dapi po jap sqarimet përkatëse. Unë vërtet jap mësim në një shkollë private dhe kam nënshkruar një kontratë me të cilën, është abuzuar, dhe është marrë vetëm pjesa e parë e kontratës shabllon, të cilën e nënshkruan çdo mësues, por duke e bërë ashtu siç e kanë bërë, nuk e kanë marrë dhe aneksin e kontratës sime, të cilën e kam nënshkruar së bashku me shkollën, dhënien e katër orëve mësimore, të cilën ma lejon ligji. Janë vetëm katër orë mësimore. Nuk më lejon ligji më shumë, dhe nuk kam marrë asnjë orë më shumë. Gjë që është e vërtetueshme dhe të cilën sistemi arsimor që punon vetëm me një SMIP ku hidhen temat mësimore dhe unë jap vetëm katër orë mësimore të cilën ma lejon ligji. Po të dëshirojnë, unë të gjithë kolegëve dashakeqës, të cilët u morën me atë kontratë, unë u jap edhe ligjin, numrin, datën të cilën e kam depozituar pranë shkollës në të cilën unë punoj. Kontrata ime ka edhe një aneks nga mbrapa, të cilën nuk kanë dashur as ta marrin as ta lexojnë, atë aneks kontratën. Kjo ishte e para. Dhe e dyta, në vazhdimësi të të gjithë procedurës ashtu siç e tha edhe nënkryetari, kjo që po diskutojmë është hapi i parë në të cilën përcillet dokumentacioni, të cilën shoqëria do t'ja bashkëngjisë Ministrisë së Bujqësisë dhe Fushë-Krujës, e cila bën vlerësimin e bonitetit të tokës, në të gjitha ato pikat që duhet të kopsisë shoqëria është një pikë që duhet ta lejojë Këshilli Bashkiak, ti hapi të drejtën e fillimit të procedurës. Kjo shoqëri ka ardhur edhe në Këshillin e Qarkut, ku është Inspektoriati i Mbrojtjes së Tokës, i cili e ka filluar punën për vlerësimin e gjithë këtyre dëmeve, siç e kanë ata procedurën. I gjithë dokumentacioni i kopsitur i shkon Ministrisë dhe ajo e bën vlerësimin e të gjithë bonitetit.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë sa për sqarim. Unë u interesova pranë medias në fjalë. Sa për dijeni këtë gjë Znj.Sema nuk e ka nga kolegët këtu, por kushedi nga e ka. Keni tek grupi i Kryesisë kontratën në fjalë. Visa po gënjes sepse aty është pasqyruar edhe aneks- kontrata. Mirë bën që punon por të zbatojë rregullat dhe ligjet e shtetit dhe të mos punoj fshehurazi.

Znj.Evis Sema

Nuk punoj fshehurazi unë , i nderuara koleg. Bëj deklaratimet tatimore dhe të pasurisë çdo vit se e kam detyrim ligjor, dhe jam vërtet në rregull me ligjin.

Znj. Antoneta Çunaj

Nuk kemi punë me kontratat, nuk merremi me problemet personale të këshilltarëve. Ti nqs ke ankesa ka procedura të tjera, jo këtu. E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 31 vota.

Kundra 4 vota.

Abstenim s`ka .

Miratohet.

Z.Endri Jaupaj

Të lutem kryetare do të më thuash votat pro.

Znj. Antoneta Çunaj

Të gjithë janë pro, vetëm katër vota janë kundra, numuroi.

Z.Endri Jaupaj

E ke detyrim ligjor për të gjitha pikat të ndash votat pro dhe kundër, mos e bëj më këtë se do të mbash përgjegjësi.

Znj. Antoneta Çunaj

Numëroi , ja ku i ke.

Z.Endri Jaupaj

Duhet ta bësh ti sepse je ti aty, nuk jam unë. Jep dorëheqjen ti se i numërojë unë. E ke detyrim ligjor ta bësh .

Znj. Antoneta Çunaj

Të lutem sekretar.

Z.Arnando Çupa

Janë gjithsej 35 këshilltarë prezent në këtë moment, 4(katër) vota kundra, 31(tridhjetë e një) vota pro dhe asnjë votë abstenim.

Z.Endri Jaupaj

Në çdo pikë të rendit të ditës duhet të deklarosh votat pro, kundra dhe abstenim.Zbatoni rregulloren sepse këto pasqyrohen në procesverbal tek ato që firmosim. Duhet të kesh kuorumin.

Pika e trembëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e ndryshimit (shtesë fondesh të trashëguara nga Granti i Performancës me burim financimi buxheti i shtetit, si dhe shtesë në buxhet për Grantin e Performancës bazuar në financim të huaj) në VKB nr. 118, datë 11.12.2025, ‘Për miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA) 2026–2028 dhe të buxhetit të Bashkisë Fier për vitin 2026’.”

Znj. Antoneta Çunaj

A ka ndonjë nga këshilltarët ndonjë paqartësi? E do ndonjëri fjalën? Materiali ju ka ardhur elektronikisht. A ka ndonjëri? Jo. Të flasi përfaqësuesi i bashkisë.

Znj.Pranvera Cina

Faleminderit kryetare! Përshëndetje të gjithëve! Së pari do t’ju shpjegoj se çfarë do të thotë një Grant i bazuar në performancë. Është një mekanizëm, i bashkëfinancuar nga qeveria Shqipëtare, ajo Zviceriane dhe ajo Suedeze. Bazuar në Ligjin për buxhetin e vitit 2025, ka dal udhëzimi i përbashkët i Ministrisë së Financave dhe të Ministrisë së Shtetit të Pushtetit Vendor. Nisur nga shkresa e Ministrisë së Financave drejtuar Bashkisë Fier, mbi bërjen e detajimit të fondit të Grantit të bazuar mbi performancën në bashki të vitit 2025 me burim financimi nga buxheti i shtetit si edhe dërgimi i shkresës përcjellëse mbi vendimin përfundimtar të Komisionit të Vlerësimit të Performancës në kuadër të Grantit bazuar në performancën e vitit 2025.

Z.Ilia Fili

Materialin e kemi përpara, nuk është nevoja ta lexoni.



Znj. Antoneta Çunaj

Unë prandaj ju thashë që në fillim që materiali ju është dërguar elektronikisht dhe nëse kishte ndonjë pyetje sepse materialin e keni përpara, dhe prandaj ju pyeta paraprakisht: A ka ndonjëri ndonjë vërejtje, sygjerim? Nqs nuk ka e hedhim në votim.

Z.Endri Jaupaj

Thjesht për sqarim, se mbase jemi gabim. Mos jemi gjë qyteti i fundit në 61 bashki për investime? Thjesht për gorrigjim. Me treguesit e performancës, jemi të fundit, qyteti i fundit për investime ? Po apo jo? Sepse ju jeni financa dhe ju duhet ta dini. A jemi të fundit në 61 bashki për investime?

Znj.Eleni Gjikonaj

Jo nuk jemi të fundit.

Z.Endri Jaupaj

Po të sajttët jemi? Atje ku duhet të ishim të parët jemi të fundit, dhe atje ku duhet të ishim të fundit jemi të parët. Për bizneset, për të ardhurat për çdo gjë jemi ku thërret qameti.

Znj. Antoneta Çunaj

Të lutem Z.Jaupaj kjo që po thoni ju është jashtë projekt-vendimit që po diskutojmë. Ka dikush ndonjë diskutim tjetër për këtë projekt-vendim? Po inxhinier.

Z.Endri Jaupaj

Inxhinieri këtu është një anëtarë që e merr fjalën i fundit, pra është anëtarë i këshillit nuk është kryetar grupi. Po e bën gabim kryetare.

Znj. Antoneta Çunaj

Po ju mbaruat. Po diskutoni jashtë projekt-vendimit, pra jashtë pikës së rendit të ditës.

Z.Endri Jaupaj

Jo jo të lutem, zonja Cina vazhdoni relatinimin për pikën e rendit të ditës. Nuk mund të ikim këtu me shijet e profesorit, me gjithë respektin që kam për profesorin.

Znj. Antoneta Çunaj

Mos u bëj cinik se përse inxhinieri kërkoi fjalën, e para për shkak të moshës por edhe sepse ta kam dhënë fjalën në çdo projekt-vendim. Vazhdoni inxhinier.

Z.Ilia Fili

Së pari, nuk dua të hyjë në debat, por mqs shtroi kolegu pyetjen. Ne jemi në fund të muajit janar, duke patur parasysh analizën e bërë për 2024 në 2025. A është e mundur të na thotë bashkia me një shifër të saktë në këtë moment, si janë realizuar investimet për 2025?

Znj.Eleni Gjikonaj



Përsëritet të gjithëve! Ky është një Grant të cilin e kemi përfituar . Treguesit e performancës mqs jemi këtu tek treguesit e performancës...

Z.Endri Jaupaj

Aty shihet puna e bashkisë tek treguesit e performancës. Më vjen keq tek treguesit e performancës është e gjithë puna juaj si ekzekutiv. Atje duket puna juaj

Znj. Antoneta Çunaj

Mos fol pa radhë, lëre të flasi përfaqësuesja e bashkisë.

Znj.Eleni Gjikonaj

Në muajin shkurt do të vijë informacioni i kërkuar. Deri në datën 27 janar kemi punuar me vitin 2025 dhe akoma nuk e kemi nxjerrë raportin e monitorimit për vitin 2025. Do të vijmë këtu në këshill që do ta miratojmë dhe do t'ju informojmë në shkurt.

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit! E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.

Kundra 2 vota.

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e katërbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Ervis Ferko, banues në fshatin Qarr, Njësia Administrative Levan, i dëmtuar nga zjarri i datës 03.01.2026.”

Znj. Antoneta Çunaj

Është mbledhur komisioni fillimisht?

Z.Kreshnik Dapi

Komisioni i Emergjencave Civile është mbledhur për pikën katërbëdhjetë dhe për pikën pesëmbëdhjetë. Janë marrë në shqyrtim të gjitha dokumentat e paraqitura nga Drejtori i Emergjencave Civile, Z.Bani. Çdo gjë ka qënë konform ligjit dhe korrekte dhe kemi votuar pro dërgimit të tyre në këshill. Faleminderit!

Znj. Antoneta Çunaj

Sqarime të tjera apo diskutime ka nga anëtarët e këshillit për këto dy projekt -vendime të djegjeve nga zjarri?

Z.Nustret Avdullaj

Më fal kryetare. Sa për të qënë të qartë. Kush e ka radhën për të diskutuar? E ka administrata? E ka komisioni? Apo e kanë anëtarët e këshillit?

Znj. Antoneta Çunaj

Në fillim flet komisioni. Pastaj unë jua jap fjalën këshilltarëve nëse kanë ndonjë paqartësi.

Z.Endri Jaupaj

E keni gabim. Ai që e ka relatuar pastaj komisioni dhe më pas kryetarët e grupeve.

Znj. Antoneta Çunaj

Jo nuk është ashtu. Fillimisht flet komisioni, pas tij flasin këshilltarët dhe nëse doni ju këshilltarë dhe keni paqartësi jep shpjegime administrata.

Z.Nustret Avdullaj

Nuk është me dëshirë kjo.

Znj. Antoneta Çunaj

Edhe unë këtë jam duke thënë.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë kryetare, si sekretar i Kryesisë po ju citoj rregulloren, të cilën e kam thënë edhe në mbledhje të tjera.

Z.Nustret Avdullaj

Me gjithë respektin që kam për ty nuk e dua përgjigjen nga ty.

Znj. Antoneta Çunaj

Materiali ju ka ardhur. Fillimisht pyes këshilltarët nëse kanë ndonjë sqarim, pyetje apo interpretim në lidhje me materialin që ju ka ardhur.

Z.Kreshnik Dapi

Me leje kryetare, se po them diçka me rëndësi për problematikën që ngrii Z.Nustret. Tani në bazë të rregullores, administrata paraqet të gjithë projekt-vendimet dhe relacionet përkatëse. Caktohet mbledhja e komisioneve. Në komisione, anëtarët e komisioneve me titullarët e administratës, kërkojnë shpjegim me gojë dhe me letra për çdo problem që ata evidentojnë. Në mbledhjen e këshillit, dhe u bëj vërejtje zotërinjëve të administratës, këshilltarët ngrihen dhe ngrenë vërejtje dhe shqetësime me gojë. Në bazë të rregullores kërkesat e këshilltarëve të ngritura në formë verbale, duhet ti kthehet përgjigje brenda 15(pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike. Kërkesave që vijnë me shkrim t'u kthehet përgjigje brenda 10(dhjetë) ditëve. Dhe Z.Nustret, bëri mirë që doli në këtë pikë sepse e kishim harruar pa e thënë. Edhe tek pika 6(gjashtë) që e tërhoqëm nga rendi i ditës, mqs Z.Arbion është aty dhe po na dëgjon, ne kemi kërkuar tre muaj rresht një relacionin të detajuar ekonomik për banesat sociale dhe ajo vjen me një projekt-vendim.

Znj. Antoneta Çunaj

Iku ai projekt-vendim, nuk është në rend dite.

Z.Kreshnik Dapi

Atëherë mbas pikës së rendit të ditës flet komisioni, pastaj flasin me radhë, titullarët e bashkisë flasin në fund mbas pyetjeve që kanë këshilltarët.

19

Znj. Antoneta Çunaj

Nqs nuk ka pyetje, nuk ka diskutime, nuk ka sqarime dhe komisioni është mbledhur nuk është e nevojshme për të folur përfaqësuesit e bashkisë.

Z.Melsi Bogdani

Kryetare, nënkryetari sapo pyeti se si duhet të vijojë mbledhja. Këtu kam një material të cilin e ka përgatitur dikush. Relaton ai që e ka përgatitur materialin, pastaj ngrihet komisioni dhe pastaj i jepet fjala dikujt nga ne që ka pyetje. Por kur merrë udhë mbledhja në këtë mënyrë, i jepet direkt fjala në seancë plenare kujtdo nga anëtarët e këshillit, nuk merr rrugën e duhur mbledhja. Nënkryetari ka të drejtë. Çdo material këtu është i përgatitur nga dikush. I jepet fjala atij që e ka përgatitur materialin pastaj i jepet fjala komisionit përkatës (që është i dyti) dhe pastaj i jepet fjala çdo kujt kush e do fjalën, dhe prandaj bëhet kaq rrëmujë këtu.

Z.Endri Jaupaj

Po përse nuk ja keni thënë më përpara? Sepse ajo ka tre vjet që e bën në këtë formë, tani do ta rregullojë ajo?

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e pesëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për trajtimin me ndihmë financiare të familjes së shtetasit Vladimir Kolonjari, banues në lagjen ‘Kastriot’, Njësia Administrative nr. 4, i dëmtuar nga zjarri i datës 17.12.2025.”

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka.

Abstenim s'ka.

Miratohet.

Pika e gjashtëmbëdhjetë e rendit të ditës.

Projekt – vendim: “Për miratimin e dhënies së ndihmës financiare të menjëhershme për mbulimin e shpenzimeve të varrimit, për humbjen e vajzës së tyre, shtetasit Algisjon Kazanxhi.”

Znj. Antoneta Çunaj

E keni të qartë këtë projekt-vendim?

Z.Endri Jaupaj

E kemi diskutuar në komision dhe jemi të qartë.

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e parë shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim: “Për autorizimin e ekzekutiv të Bashkisë Fier për përfaqësim ligjor dhe mbrojtje juridike pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë edhe nëpërmjet shërbimit juridik të kryer nga një Studio Avokatie , në procesin gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë .

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht të flasi përfaqësuesja e administratës.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Nuk e di nëse i keni marrë materialet apo jo, edhe projekt -vendimin dhe relacionin?

Z.Endri Jaupaj

Materialet kanë ardhur mbrëmë apo jo?

Z.Arnando Çupa

Kjo pikë është pasqyruar që ditën që është mbajtur mbledhja e kryesisë dhe është pasqyruar menjëherë mbasi është mbledhur kryesia dhe është protokolluar po atë ditë. Nuk është futur në rendin e ditës pasi ka ardhur pasi ka përfunduar mbledhja e kryesisë.

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Fillimisht dua t'ju them që kam dhënë një informacion të hollësishëm tek relacioni mqs është pjesë tashmë e shqyrtimit në Gjykatën Administrative. Bëhet fjalë në lidhje me inspektimin e ushtruar nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve pranë parkimit nëntokësor në qendër të qytetit të Fierit, ku pas vlerësimit dhe inspektimit janë lëshuar njoftimet e vlerësimeve tatimore si dhe masa administrative e sanksionit me gjobë për mosmbajtjen e kasës fiskale.Këto njoftime të Policisë Tatimore janë ankuar konform ligjit në Drejtorinë e Apelit Tatimor, ku nga ana e asaj drejtorie me vendim marrjen e saj, është pranuar pjesërisht duke e lënë në fuqi njoftimin e vlerësimeve tatimore për masën e sanksionit me gjobë. Por çështja nuk shtrohet këtu. Çështja shtrohet më gjerë sepse në bazë të këtyre njoftimeve të vlerësimeve tatimor, ata e padisin Bashkinë Fier jo si Pushtet Vendor që ne për parkimin kemi miratuar tarifë vendore, por ata e trajtojnë në bazë të ligjit të procedurave tatimore 9920 duke e trajtuar Bashkinë Fier, si Ent Publik që duhet të regjistrohet dhe duhet të hapi një NIPT sekondarë dhe të pajiset konform ligjit për procedurat tatimore. Në kushtet kur ne me paketën fiskale, çdo vit Këshilli I Bashkisë Fier, përse i



përket shërbimit të parkimit, ka miratuar një tarifë vendore e cila lidhet me të njëjtat nisma të marrë nga struktura e Bashkisë Fier, kjo përbën një çështje një mosmarrëveshje midis pjesës së miratimit të paketës fiskale dhe trajtimit të shërbimit të parkimit si shërbim vendor dhe pjesës tjetër pastaj siç e trajton ligji për procedurat tatimore që është pjesë e shqyrtimit administrative në gjykatë që të regjistrohet dhe të pajiset me fiskalizim, pra të hapi një NIPT sekondarë, të pajiset me kasë fiskale dhe faturë tatimore. Ky objekt është tashmë objekt shqyrtimi në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ku është paditur nga Bashkia Fier kundër vendimit të Drejtorisë së Apelimit Tatimor, Sektori i Apelimit të Dënimeve në Ministrinë e Financave, dhe me pjesëmarrjen e Avokaturës së Shtetit. Në kushtet kur objekti kryesor është Ligji për Procedurat Tatimore, është një ligj specifik për Drejtorinë e Tatimeve dhe jo për Bashkinë Fier, dhe duke qënë pjesë e analizimit dhe e shqyrtimit ligji për taksat dhe tarifatat vendore, ligji për procedurat tatimore, e vlerësojmë që krahas përfaqësimit të Ekzekutivit nga ana jonë si Drejtori Juridike, të kemi dhe një suport nga një studio që ka eksperiencë në këtë fushë. Tarifa që do t'i jepet avokatit përfaqësues atje do të jetë tarifa referuese e miratuar sipas legjislacionit në fuqi.

Z.Kristian Kina

Kam një pyetje. Kjo a mundet të zëvendësohet përfaqësimi nga juristët e bashkisë? Pse duhet të shpenzohet, mbase për një pjesë që mund të kryhet nga juristët e bashkisë?

Znj.Esmeralda Kapllanaj

Patjetër që Drejtoria Juridike që përfaqëson dhe mbron interest ligjore të Bashkisë Fier. Në rastin konkret ajo që i referohen aktet e Drejtorisë së Ankimit Tatimor, bëhet fjalë për interpretimin ligjor që është kërkuar dhe në rrugë administrative, është ligji për procedurat tatimore. Ligji për Procedurat Tatimore 9920, nuk është objekt i shqyrtimit nga ana jonë. Ne këtu si Pushtet Vendor Ekzekutiv dhe Këshill, kemi Ligjin për Qeverisjen Vendore dhe 9632 për Taksat dhe Tarifatat Vendore. Kjo kontraditë dhe pjesë e interpretimit ligjor, ka bërë që të dali kjo vendimmarrje e Drejtorisë së Apelimit Tatimor. Ku ne duke qënë se tashmë kemi miratuar në paketë fiskale që shërbimin e parkimit e kemi tarifuar me tarifë përkatëse do ta shqyrtojmë në pjesën administrative, kjo është, pra ka një natyrë tjetër, të veçantë, nuk është pjesë e taksave vendore është pjesë e procedurave të fiskalizimit. Patjetër që Bashkia Fier ka edhe përfaqësuesit e vet. Shumica e bashkive të vendit mund të lidhin dhe marrëveshje direkt me Avokaturën e Shtetit, nuk ka të bëjë kjo, e ka parashikuar ligji. Derisa ligji parashikon që për natyra të veçanta juridike mund të kontraktosh, nuk ka asnjë gjë këtu. Tarifatat janë referuese nuk abuzohet me tarifatat, janë tarifa të miratuara në bazë të udhëzimit të Ministrisë së Drejtësisë dhe konform marrëveshjes së nënshkruar do të vijohet procedura.

Znj. Antoneta Çunaj

A ka sqarime të tjera nga anëtarët e këshillit? E hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 34 vota.


Kundra 2 vota .

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e dytë shtesë e rendit të ditës.

22



Projekt- vendim:“Për miratimin e marrëveshjes së investimit të lidhur nëpërmjet Bashkisë Fier dhe Fondit Shqiptar të Zhvillimit për projektin infrastrukturor “ Nderhyrje për Rikonstruksionin e Rrugës : Rotondo pranë Kishës Katolike Fier-Hyrje Patos , Bashkia Fier”, dhe autorizimin e ekzekutivit për fillimin e procedurave administrative-ligjore të pasurive të paluajtshme për shpronësim për interes publik” me qëllim vazhdimin e procedurave ligjore për pajisjen me leje infrastrukture.

Znj. Antoneta Çunaj

Fillimisht të flasi përfaqësuesi i administratës dhe më pas me radhë.

Z.Arbion Behari

Në kuadër të realizimit të projekteve me interes publik , dhe bashkëpunimit institucional me Fondin Shqiptar të Zhvillimit nga Bashkia Fier është aplikuar për financim projekti “Ndërhyrje për Rikonstruksionin e Rrugës : Rotondo pranë Kishës Katolike Fier-Hyrje Patos , segment i cili parashikon, project i cili parashikon investimin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit për ndërtimin e trotuareve, zgjerimin e kësaj rruge, ndërtimin e korsive të biçikletave etje. Pjesë e kësaj marrëveshje është se Bashkia Fier do të vijojë me procedurën e shpronësimit të pasurive pronë private që preken nga ky projekt si dhe paisjen me lejen infrastrukturore të subjektit që do të zbatojë këtë projekt. Në vijim të kësaj ne jemi drejtuar këshillit dhe i kemi kërkuar miratimin e marrëveshjes si dhe autorizimin e ekzekutivit për vijimin e procedurave të vlefshme administrative ligjore të pronave për shpronësimin e pasurive pronë private që preken nga ky projekt.

Z.Endri Jaupaj

Duke qënë se po flasim për shpronësimet, është bërë dëgjese publike për këto prona që do të preken ?

Z.Arbion Behari

Çdo projekt i hartuar nga FSHZH-ja paraprihet nga konsultimet dhe dëgjesat publike me banorët e zonave ku do të zbatohet projekti.

Z.Endri Jaupaj

Tek këto dëgjesat publike, çfarë është kërkuar dhe çfarë është thënë? Banorët çfarë pretendimesh kanë?

Z.Arbion Behari

Banorët nuk kanë pretendime, janë dakort me projektin e paraqitur.

Z.Endri Jaupaj

Të gjithë banorët janë dakort apo një pjesë?

Z.Arbion Behari

Të gjithë.

Z.Endri Jaupaj

Nqs janë banorët dakort, pse mos të jemi ne .

Znj. Antoneta Çunaj

E hedhim në votim.Kush është pro?

Pro 35 vota.

23



Kundra 1 votë .

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e tretë shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Për ngritjen e Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndihmë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier”

Znj. Antoneta Çunaj

Kjo pikë e rendit të ditës është kërkuar edhe nga ana jonë si Këshill Bashkiak dhe nga Kryesia. Fillimisht të plasi përfaqësuesi i bashkisë.

Znj.Pranvera Cina

Ky projekt-vendim vjen si rrjedhojë e kërkesave të shumta që janë paraqitur pranë Bashkisë Fier drejtuar dhe Bashkisë Fier dhe Këshillit të Bashkisë. Besoj ju kanë ardhur edhe juve disa kërkesa për rastet e vështira në të cilën ndodhen disa individ, familje për shkak të kushteve ekonomike sociale dhe për nevojat e riparimit të banesave. Është menduar që të ngrihet një komision vendimmarrës i posaçëm i përbërë prej pesë anëtarësh ku tre anëtarë do të jenë përfaqësues të Bashkisë Fier, një do të jetë nga Shërbimi Social, nga Sektori i Financë-buxhetit dhe nga sektori Juridik dhe dy anëtarë do të jenë përfaqësues të Këshillit Bashkiak Fier që do ti vendosni ju këtu bashkarisht sepse do të jenë përfaqësuesit tuaj në këtë komision.

Z.Endri Jaupaj

Më falni, sa për sqarim. Ne e kemi Komisionin e Strehimit që e kemi goxha të konsoliduar, e kemi Ad-Hock me përfaqësues të Ekzekutivit të Bashkisë dhe unë mendoj që është e kotë ngritja e këtij komisioni të dytë.

Znj. Antoneta Çunaj

Po ata janë.

Z.Endri Jaupaj

Një sekondë! Po mirë ata janë, por jemi tre me dy.

Znj.Mirela Pitushi

Po ti e kërrove vetë, o Endri.

Z.Endri Jaupaj

E kërкова unë, po pse mos të jemi ne katër anëtarë të Këshillit Bashkiak dhe administrata të ketë tre anëtarë.


Znj. Antoneta Çunaj

Propozimet përse i përket numrit bëjini vetë.

Z.Endri Jaupaj

Po me strukturën tre nga ekzekutivi dhe dy nga ne sikur nuk ka kuptim.

Znj. Antoneta Çunaj



Po ne shqyr qe e arritem ketë moment, vazhdo Z.Dapi.

Z.Endri Jaupaj

Nuk jam kundra, e kisha vetem tek numri qe te ishte katër me tre në raport të anëtarëve të këshillit me administratën mqs ne e kemi një komision Ad-Hock të strehimit me një përbërje të ngjashme i cili funksionon më së miri.

Znj. Antoneta Çunaj

Vazhdo Z.Dapi

Z.Kreshnik Dapi

Ky është një projekt-vendim i minutës së fundit. Nga ana ime shpreh falenderimet për Ekzekutivin që pas shumë kërkesave, unë kam qënë nga më këmbëngulësit, duke qënë në kontakt të vazhdueshëm me kërkesat që vijnë në Kryesinë e Këshillit dhe si Kryetar i Komisionit të Emergjencave Civile dhe si anëtarë i Kryesisë dhe si anëtarë i Komisionit të Strehimit. Dhe gjej rastin këtu të falenderoj personat që bënë të mundur krijimin e këtij projekt-vendimi. Dua gjithashtu t'ju bëj me dije që numri i kërkesave relativisht është i lartë dhe vazhdon përditë të shtohet. Dua gjithashtu që edhe publiku, pra qytetarët që na ndjekin tani live, t'ju bëj me dije që humanizmi dhe dëshira jonë për ti ndihmuar është në nivelet maksimale, por kjo nuk shkon njëtrajtësisht me mundësitë reale të bashkisë. Komisionin ne do të mundohemi ta përbëjmë me njerëz human po e po, sepse këtu ashtu janë të gjithë, por dhe me njerëz konkret dhe me njerëz që janë të vetëdijshëm për përgjegjësitë që po marrin mbi supe, dhe do të mundohemi që me ato të ardhura që ka Bashkia Fier, t'i vijmë në ndihmë të gjithë rasteve që ligjërisht e meritojnë ta marrin këtë ndihmë. Faleminderit edhe njëherë!

Znj. Antoneta Çunaj

Faleminderit! Tani e hedhim në votim. Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Pika e katërt shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Rikonstruksioni i argjinaturës për mbrojtjen nga lumi Vjosa (bankina e krahut të majtë të Degës së Martines, prog. 9958–11308 ml), zona Ferras – Ura e Qarrit, L = 1350 ml”, Bashkia Fier”

Znj. Antoneta Çunaj

Ky projekt- vendim e keni të qartë besoj, ka të bëjë me situatat e përmbytjeve që shkaktohen nga lumi Vjosa dhe masat që duhen marrë për parandalimin e tyre. Më konkretisht le të flasi përfaqësuesi i bashkisë.

Z.Erald Qirjo

Këto dy projekt-vendimet e fundit, janë përgatitur në kuadrin e thirrjes që ka bërë Drejtoria e Përgjithëshme e Emergjencave Civile në Tiranë, për ngritjen dhe forcimin e argjinaturave. Disa

segmente të tjera të argjinaturës janë bërë edhe përpara sikurse jeni dhe ju në dijeni, këto dy projekt vendime janë vazhdim i asaj procedure që është bërë edhe më përpara.

Z.Endri Jaupaj

Duhet të ishin bërë më përpara sepse kemi qënë dhe vetë si komision në terren.

Z.Erald Qirjo

Sepse Endri, nuk e di nëse ke qënë atje apo jo, lumi nuk doli mbi argjinaturë, ti e di shumë mirë

Z.Endri Jaupaj

Isha prandaj thashë që duhet ta kishin bërë kohë më përpara.

Z.Dule Troka

Mund të bëhet ndonjë ndërhyrje pak para kohe tek pjesa e Kalinorës, janë nja dy dëmtime, se nuk dihet se kur mund t'i vijë radha dhe mund të mbushen. Mund të bëhet ndonja ndërhyrje para kohe se një shi të bjeri në Kalinoren që vjen nga Peshtani rrezikohen prapë, se janë nja dy fermer atje poshtë, janë serat e tyre, Mund të bëhet një ndërhyrje para kohe jo e plotë por emergjente.

Z.Erald Qirjo

Këtë problematikën që po më ngre, së bashku me drejtorin e Bordit të Kullimit, do të shkojmë bashkë ta shikojmë atje në vend që nesër.

Z.Elvi Daka

Diçka shumë shkurt lidhur me pjesën e argjinaturave. Mqs unë si përfaqësues i një nga zonave të përmbytura, dhe dua të falenderojë njëkohësisht edhe për reagimin e menjëhershëm të institucioneve pas përmbytjes fatkeqësisht. Dua të sjellë në vëmendjen e bashkisë dhe jo vetëm të të gjitha institucioneve edhe qendrore, që pjesa e argjinaturës në segmentin Alibeas-Adriatik deri në buzën e detit, në zonën e Libofshës është për t'u riparë në një kohë kur të jetë pak më thatësirë, por ka nevojë për një ndërhyrje të menjëherëshme, ndryshe pas kaq vitesh që përjetuam përmbytjen e parë. Nqs vazhdon të lihet në këtë gjendje do të kemi të tjera përmbytje.

Znj. Antoneta Çunaj

Ju lutem këshilltarëve të fokusohen në këto dy projekt-vendime dhe të mos flasin jashtë rendit të ditës. Do të bëhen edhe shumë gjëra të tjera por le të fokusohemi tek këto dy projekt vendime që kanë të bëjnë me lumin Vjosa. Le ta hedhim në votim pikën katër shtesë të rendit të ditës. Kush është dakort?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka .


Miratohet.

Pika e pestë shtesë e rendit të ditës.

Projekt- vendim:“ Mbrojtja nga përmbytja e lumit Vjosa – mbingritja e argjinaturës, zona Kalinores – Klose, vazhdimi i pjesës II (e dytë), L = 1980 m, Bashkia Fier”.

Znj. Antoneta Çunaj

26



E hedhim në votim .Kush është pro?

Pro 36 vota.

Kundra s'ka .

Abstenim s'ka .

Miratohet.

Znj. Antoneta Çunaj

Ne mbaruam, faleminderit!

Znj.Eleni Gjikondaj

Ju lutem përcaktoni emrat e anëtarëve të Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndihmë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier.

Znj. Antoneta Çunaj

Të lutem Znj.Gjikondaj përcaktimin e emrave të anëtarëve të Komisionit për Trajtimin e Kërkesave për Ndihmë të Menjëhershme dhe për Riparim Banesash pranë Bashkisë Fier do ta miratojmë në mbledhjen tjetër .

Me kaq mbledhjen e deklarojë të mbyllur duke ju falenderuar për pjesëmarrjen dhe bashkëpunimin!

Ky procesverbal ka 27 (njëzet e shtatë) faqe dhe mbahet në tre kopje nga ana e Sekretarit të Këshillit


Z. Arnando Çupa.

Sekretar i Këshillit

Arnando Çupa



Këshilltar
Fteshnik Dapi



Kryetar i Këshillit

Antoneta Çunaj



Arben Culo



Eudhi Jaupaj



KESHILLTARE

Arben Culo